



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUÇOVË

Nr. 3743 Prot.

Kuçove me 06/12/2022

VENDIM

Nr. 72 datë 30.11.2022

“Mbi Miratimin e Kritereve te Dhenies se Ndhimes Ekonomike nga Fond i Kushtezuar per Bllok-Ndihmen Ekonomike deri ne 6% dhe/ose me Fondet e Buxhetit Vendor.”

Keshilli I Bashkise në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetë qeverisjen vendore”, nenit 21 të ligjit nr.57/2019 “Për Asistencen Sociale ne Republiken e Shqiperise”kreulV,pika 1 dhe 2 e VKM-se nr 597,date 04.09.2019”Per percaktimin e procedurave ,te dokumentacionit dhe mases mujore te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fondin e Kushtezuar per ndihmen ekonomike” “, Udhëzimit nr.5 dt.17.02.2017” Titulli I ndryshuar “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 përqind” I ndryshuar me propozim te Drejtorise se Shërbimit Social,

VENDOSI:

1.Te miratoje kriteret per dhenien e ndihmes ekonomike nga fondi shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike I cili eshte 6% e ketij fondi dhe mbi kete fond mund te shtohen ose jo edhe fondet e buxhetit vendor.

2.Kriteret sipas pikes numer 1 te ketij projekt-vendimi jane si me poshte :

a)Familjet e varfra te cilat nuk jane shpallur perfituese nga sistemi I pikezimit.

b)Familje me krye familjare gra qe jane te ve ,te divorcuara,vajze nene ne veshtiresi ekonomike dhe sociale.

c)Persona te paafte ,te vetmuar te cilet nuk kane asnje burim te ardhurash.

d)Familje me femije ne risk,referuar ngaNjesia e Mbrojtjes se Femijve .

e)Persona te cilet jane te dhunuar ne familje ,trafikimit apo perdorues te substancave psiko-aktive.

f) Familje qe kane ne perberje anetare mbi moshe pune.

g) Familje qe penalizohen nga sistemi per mos plotesimin e kritereve ligjore

Duke pare ecurine e punes u duke e nevjoshme shtimi I nje kriteri germa g) per perfitimin e ndihmes ekonomike ;

g) Familje qe penalizohen ngasistemi per mosplotesimin e kritereve ligjore

3. Dokumentat e aplikuesve te jene sipas VKM nr 597, date 04.09.2019 "Per percaktimin e procedurave ,te dokumentacionit dhe te mases mujore te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike"

4. Masa e Ndhimes Ekonomike te perlogaritet sipas VKM nr.597, date 04.09.2019"Per percaktimin e procedurave ,te dokumentacionit dhe te mases mujore te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike "

5. Ngarkohen per zbatimin e ketij vendimi drejtoria e Sherbimit Social.

6. Ky vendim u miratua 21 vota pro, — vota kunder , — vota abstenim, ne presence te 21 anetareve te Keshillit bashkiak.

KRYETAR I KESHILLIT BASHKIAK

MIGENA BULLARI

